




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME DHE DIASPORËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, maj 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MPJD kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

- 1 Kontratat dhe pagesat e klasifikuara të MPJD-së, nuk janë audituar dhe nuk janë pjesë e këtij raporti.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministrja e MPJD-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Sa i përket menaxhimit financiar, edhe pse janë vërejtur përmirësime në raport me vitet paraprake, duhet t'i kushtohet vëmendje e shtuar çështjes së avanceve të hapura dhe të pa-arsyetuara të bartura nga vitet paraprake si dhe regjistrimit të plotë të shpenzimeve. Po ashtu duhet të forcohen kontrollet në raportimin e obligimeve të pa paguara me qëllim të evitimit të gabimeve në shpalosje si dhe ekzekutimi i pagesave të bëhet nga kategoritë ekonomike adekuate në përputhje me natyrën e shpenzimit.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus më i madh t'i kushtohet vonesave në pagesa të faturave, arsytimit dhe dokumentimit të shpenzimeve të realizuara nga MDK-të në veçanti raportimit të përdorimit të automjeteve zyrtare si dhe raportimit të kontratave të realizuara për MDK-të.

Ky raport ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime, prej tyre një (1) rekomandim është i ri, një (1) rekomandim është pjesërisht i përsëritur dhe katër (4) të pa zbatuara. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Kontrollet e brendshme në raportimin financiar

Në vijim janë çështjet që kanë të bëjnë me prezantimin e të dhënave dhe përgatitjen në Pasqyra Financiare.

Çështja C1 - Avancet e pa arsyetuara dhe mos regjistrimi i plotë i shpenzimeve të MDK-ve

Gjetja Neni 20 i Rregullores së MF nr. 01/2017 për Raportim Vjetor të Organizatave Buxhetore, përcakton se "Avancet e dhëna si para të gatshme si para të imëta, udhëtime zyrtare dhe /paratë e dhëna në dorë për ambasadat dhe shpenzimet e pa regjistruara nga llogaritë e ambasadave duhet të mbyllën (arsyetohen) në mënyrë që të paraqiten si shpenzime në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare të organizatës buxhetore".

Për vitin 2023 gjendja e parave të gatshme dhe avanceve të hapura në MPJD përfshirë Misionet Diplommatike dhe Konsullore (MDK) e raportuar në Pasqyra Financiare Vjetore (PFV) ishte 213,418€. Prej tyre 192,868€ janë mjete të pa shpenzuara nga MDK-të të cilat konsiderohen mjete në dispozicion për vitin 2024. Ndërsa, avancet e hapura për udhëtimet zyrtare të raportura në PFV ishin 20,550€.

Sa i përket avanceve të hapura/të pa arsyetuara, MPJD ka një bilanc prej 125,523€ para të gatshme të pa identifikuar dhe pa-arsyetuara nga vitet e mëhershme. Ndërsa, sa i përket gjendjes së shpenzimeve të regjistruara të MDK-ve të raportuar nga ministria, kishte një mos-barazim në vlerë 18,577€ (bilanc i pa regjistruar) në mes të gjendjes së balanceve në SIMFK dhe gjendjes në bankë. Ky bilanc vjen si rezultat i hyrjeve dhe daljeve të parasë të pa regjistruara në SIMFK që mund të jenë pasojë e shpenzimeve të pa regjistruara, të hyrave dhe rimbursimeve të pa regjistruara, diferencave për shkak të kurseve të këmbimit, gabime në regjistrime etj. Megjithatë, vlen të theksohet se ka një përmirësim të gjendjes krahasuar me vitet paraprake.

Sa i përket avanceve të hapura dhe të pa arsyetuara të bartura nga vitet paraprake, ministria ende nuk ka arritur t'i identifikoj dhe të ketë evidenca të qarta rreth kësaj gjendje për t'i trajtuar tutje.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha shpenzimeve të MDK-ve në SIMFK ndikon që vlera e shpenzimeve e paraqitur në PFV të jetë e nënvlerësuar në raport me paranë e shpenzuar. Vonesa në mbylljen e avanceve të bartura nga vitet paraprake ndikon në mos identifikimin dhe evitimin e gabimeve të mundshme në llogarinë e avanceve, si dhe pasqyron shpenzime të pa mbyllura duke bërë që kjo llogari të figurojë e hapur në vazhdimësi.

Rekomandimi C1 Ministrja në bashkëpunim me Thesarin duhet të siguroj se janë ndërmarrë masa konkrete për identifikimin e shkaqeve për mos-mbylljen e avanceve të hapura të bartura ndër vite bazuar në dokumente mbështetëse si dhe të merren masa për mbylljen e tyre. Po ashtu, në vazhdimësi të forcohen kontrollet në regjistrimin e shpenzimeve të MDK-ve që të evitohen mos-barazimet dhe të pasqyrohet një evidencë e plotë e parasë së shpenzuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishte 20,933,555€, prej tyre ishin shpenzuar 19,423,170€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime të udhëtimit, rimbursime të ambasadave, shërbime tjera kontraktuese etj.

Çështja B1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Rregullorja Financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, neni 18.3 përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.

Bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet MPJD dhe Unionit të Klubeve Shqiptare të Futbollit, për organizimin e turneut të futbollit shqiptar në Zvicër (Kupa e diasporës 2023), MPJD, ka mbështetur këtë aktivitet në vlerë 4,000€ nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve edhe pse mbështetja financiare është bazuar në një marrëveshje zyrtare mbi formën e subvencionimit.

Po ashtu, bazuar në Memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet MPJD dhe OJQ "Germin", Ministria kishte kryer një pagesë në vlerë 6,431€ për transportin e 40 pjesëmarrësve të diasporës për dy javë gjatë muajit Gusht 2023, për realizimin e programit OriginAL. Pagesa është bërë në bazë të faturës së lëshuar për ministrinë nga kompania e transportit. Kjo pagesë është kryer nga kategoria mallra dhe shërbime por ministria nuk kishte kontraktuar e as zhvilluar asnjë procedure konkurruese për pranimin e këtij shërbimi dhe vetëm ka ofruar mbështetje financiare për realizimin e programit të OJQ-së e cila kishte përgatitur edhe raport narrativ për ministrinë rreth realizimit të projektit. Për nga natyra kjo formë e mbështetjes financiare i takon kategorisë subvencione dhe transfere.

Pagesat nga kategoria jo adekuate kanë ndodhur për shkak se memorandumet e bashkëpunimit nuk ishin të formuluar qartë lidhur me mënyrën e pagesës dhe ndarjen e përgjegjësisë.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate ekonomike ndikojnë në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke ofruar informata jo të sakta për lexuesit e PFV. Po ashtu ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive ekonomike jo adekuate për këto shpenzime.

Rekomandimi B1

Ministrja duhet të sigurojë se në rastet e bashkë-organizimeve të aktiviteteve me palë të jashtme të përcaktohen qartë përgjegjësitë e palëve në kontraktimin e shërbimeve dhe mënyrën e kryerjes së pagesave në mënyrë që shpenzimet të bëhen në kodet ekonomike adekuate për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Vonesa në procedimin e pagesave

Gjetja Ligji Nr.03/L-048 për MFPP, neni 39.1 përcakton se, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuar dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Pesë fatura për shërbime postare diplomatike në vlerë të përbashkët prej 8,900€ nuk ishin paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat ishin nga 24 deri në 40 ditë përtej afatit të lejuar për pagesë.

Vonesat në pagesën e faturave kishin ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme nga ana e Ministrisë.

Ndikimi Vonesat në pagesën e faturave krijojnë implikime buxhetore për vitin fiskal vijues, ku përveç pagesave të faturave Ministria mund të jetë edhe pjesë e padive nga OE si rezultat i vonesave të mëdha në kryerje të obligimeve të saj.

Rekomandimi B2 Ministria duhet të siguroj një kontroll efektiv të obligimeve që rrjedhin nga aktivitetet e Ministrisë në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor për të shmangur penalizimet për shkak vonesave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Mangësi në raportimin lidhur me përdorimin e automjeteve zyrtare nga MDK-të**

Gjetja Udhëzimi Administrativ 04/12 për përdorim të automjeteve zyrtare për MDK, neni 12.2 përcakton se: zyrtari përgjegjës për automjetet, i caktuar nga shefi i misionit diplomatik apo konsullor harton raportin me shifra për shpenzimet mujore, të plotësuar për të gjitha automjetet e Misionit, duke përfshirë raportin për secilin automjet dhe i njëjti i raporton Divizionit të Transportit/Logjistikes në MPJ.

Sipas informatave të pranuar nga Divizioni i transportit-logjistikës, vërehet se 18 Misionet Diplomatike Konsullore (MDK) për vitin 2023 kanë raportuar në baza të rregullta mujore, 5 nuk kishin raportuar fare dhe 24 kanë raportuar në periudha të ndryshme gjatë vitit.

Mos raportimi sipas kërkesave ligjore për shpenzime të transportit kishte rrjedhur si rezultat i mungesës së stafit në këto misione diplomatike dhe kontrollit lidhur me raportimin nga ana e MDK-ve.

Ndikimi Mos raportimi mujor për automjetet e MDK-ve, mund të ndikojë që automjetet zyrtare të mos përdoren për qëllime të duhura.

Rekomandimi B3 Ministria edhe më tej duhet të siguroj përmes shefave të MDK-ve që mbajtja e evidencave të bëhet për secilin automjet zyrtar dhe përdorimi i tyre të raportohet në mënyrë të rregullt mujore në Divizionin e Transportit/Logjistikes në MPJD.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 12,705,000€ dhe prej tyre gjatë vitit 2023 ishin shpenzuar 11,760,746€. Këto shpenzime kanë të bëjnë me blerjen e objekteve të ambasadave në MDK, blerje të veturave për MDK, furnizim me pajisje të teknologjisë informative etj.

Çështja B4 - Raportim jo i plotë i kontratave të nënshkruara publike

Gjetja

Sipas nenit 17.3 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOP), "Në fund të vitit autoritetet kontraktuese do të hartojnë një raport përmbledhës vjetor për çdo kontratë publike, që është nënshkruar në vitin fiskal paraprak".

Në raportin vjetor të kontratave të nënshkruara publike të MPJD-së për vitin 2023, nuk janë raportuar kontratat:

- "Blerja e objektit të ambasadës së Republikës së Kosovës në Londër" në vlerë 6,771,115€, e nënshkruar me datë 23.03.2023;
- "Blerja e objektit të ambasadës së Republikës së Kosovës në Senegal" në vlerë 1,600,000€, e nënshkruar me datë 23.02.2023;
- "Blerja e objektit të ambasadës së Republikës së Kosovës në Kroaci" në vlerë 2,950,000€, e nënshkruar me datë 12.12.2023; si dhe
- "Blerja e një veture (kombi) për ambasadën Republikës së Kosovës në Bruksel" në vlerë 60,150€ me datë 15.12.2023.

Kontratat e nënshkruara nga MDK-të nuk ishin përfshirë në raportin vjetor të kontratave publike si pasojë e pa mundësive teknike pasi që procedurat e zhvilluara të MDK-ve nuk kryhen përmes sistemit të e-prokurimit dhe nuk mund të gjenerohet raporti përmbledhës.

Ndikimi

Mos përfshirja e kontratave të realizuara për MDK-të në raportin e kontratave të nënshkruara publike nuk pasqyron një gjendje reale të kontratave të realizuara në vitin 2023. Po ashtu, duke pas parasysh faktin që këto kontrata përfshijnë 98% të buxhetit të realizuar për investime kapitale nga ministria.

Rekomandimi B4

Ministrja në bashkëpunim me "Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik" (KRPP) duhet të ndërmarrin masa në gjetjen e një alternative të qëndrueshme për përfshirjen e të gjitha kontratave të realizuara nga MDK-të në kuadër të raportit vjetor të kontratave të realizuara publike me qëllim të pasqyrit të gjendjes reale të kontratave të realizuara të ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.4 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2023, ishte 296,351€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2024.

Çështja A1 - Shpalosje jo e drejtë e obligimeve të pa paguara në PFV

Gjetja Rregullorja MF-Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore, Neni 17 përcakton se, Organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Vlera e obligimeve në PFV nuk ishte prezantuar saktë. Në totalin e obligimeve të shpalosura ishin përfshirë 13 fatura të raportuara nga dy herë duke i mbivlerësuar obligimet për 116,049€.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e një gabimi teknik dhe në mungesë të kontrolleve të mjaftueshme në evidentimin dhe raportimin e obligimeve të pa-paguara.

Ndikimi Paraqitja e faturave të njëjta si rezultat i gabimeve teknike ka ndikuar në mbivlerësim të gjendjes së raportuar të obligimeve në PFV.

Rekomandimi A1 Ministrja duhet të siguroj që kontrollet në zyrën e financave të jenë më efektive në mënyrë që të evitohen gabimet dhe të bëhet raportimi i drejtë dhe i saktë i gjendjes së obligimeve të pa-paguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	46,042,568	40,405,767	37,935,849	31,042,160	22,659,798
Grante Qeveritare - Buxheti	46,042,568	39,932,763	37,541,693	30,256,159	22,627,926
Donacionet vendore	0	100,776	94,795	104,813	6,671
Donacionet e jashtme	0	372,228	299,361	681,188	25,201

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 5,636,801€. Ky ndryshim ishte rezultat i të hyrave të pranuar nga donacionet, ndarjes së mjeteve buxhetore për mbështetje financiare për gazetarët ukrainas dhe afgan të strehuar në Kosovë si dhe vendimeve Qeveritare për kursime buxhetore.

Në vitin 2023 Ministria ka shpenzuar 37,935,849€ apo 94% të buxhetit final. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	46,042,568	40,405,767	37,935,849	31,042,160	22,659,798
Pagat dhe mëditjet	8,157,017	6,131,502	6,130,024	6,969,920	7,089,315
Mallrat dhe shërbimet	22,250,000	19,923,004	18,724,977	18,205,016	14,749,811
Komunalitë	1,010,551	1,010,551	698,193	702,400	524,655
Subvencionet dhe transferet	230,000	635,710	621,910	494,324	8,500
Investimet Kapitale	14,395,000	12,705,000	11,760,746	4,670,500	287,517

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,025,515€. Ky zvogëlim ishte rezultat i vendimit Qeveritar për harmonizime dhe kursime. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%;


Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,326,996€. Ky ndryshim ishte rezultat i zvogëlimit të mjeteve në vlerë 2,700,000€ sipas vendimit Qeveritar për kursime, zvogëlimit të buxhetit nga transferi i mjeteve në vlerë 100,000€ në kategorinë subvencione dhe transfere si dhe rritjes së buxhetit si rezultat i të hyrave nga donacionet në vlerë 473,004€. Realizimi i buxhetit final në kategorinë mallra dhe shërbime ishte 94%;

Buxheti final dhe ai fillestar për shpenzime komunale ishte 1,010,551€. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e shërbimeve komunale ishte 69%;

Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 405,710€. Kjo rritje ishte rezultat i ndarjeve të mjeteve buxhetore në vlerë 305,710€ për mbështetje financiare për gazetarët ukrainas dhe afgan të strehuar në Kosovë. Në anën tjetër, në rritje të buxhetit ka ndikuar edhe transferi i mjeteve nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në vlerë prej 100,000€. Realizimi i buxhetit final në subvencione dhe transfere ishte 98%; si dhe

Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,690,000€. Ky zvogëlim ishte si rezultat i vendimeve Qeveritare për kursime. Realizimi i buxhetit final në kategorinë e investimeve kapitale ishte 93%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



MPJD për vitin 2023, kishte realizuar të hyra në vlerë prej 6,062,650€ dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një zvogëlim prej 159,285€ në pranimet e të hyrave. Të hyrat realizohen nga taksa për dokumente të udhëtimit, taksa për verifikim të dokumenteve, taksa për letërnjoftim, taksa për shtetësi, taksa për vulë apostile dhe taksa tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	6,851,113	6,851,113	6,062,650	6,221,935	5,871,089
Të hyrat jo tatimore	6,851,113	6,851,113	5,642,929	5,912,080	5,800,262
Të hyrat tjera	0	0	419,722	309,855	70,828

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka rezultuar me 12 rekomandime.

Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, nga 12 rekomandime të dhëna, shtatë (7) rekomandime janë zbatuar, katër (4) rekomandime nuk janë zbatuar si dhe një (1) rekomandim është zbatuar pjesërisht.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Ministria duhet të sigurojë se janë identifikuar të gjitha rastet e tilla lidhur me mbështetjen financiare të mësimdhënësve dhe për mjete të cilat nuk janë pranuar nga mësimdhënësit të ndërmerren veprime për kthimin e tyre dhe të shpërndahen tek mësimdhënësit.	Sipas raportimit nga zyrtarët e ministrisë çështja është adresuar tek organet përgjegjëse. Sa i përket vitit 2023 nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar

2.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Ministrja edhe më tej duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet raportohen nga Misionet Diplommatike dhe Konsullore me kohë për të mundur regjistrimin e tyre në SIMFK dhe raportimin në fund të vitit në PFV si shpenzime të Ministrisë.	Edhe këtë vit ka mos-barazime në regjistrime (shpenzime të pa regjistruara) por në raport me vitet paraprake gjenjda është përmirësuar.	Pjesërisht i zbatuar
3.	Pagat dhe mëditjet	Ministrja duhet të siguroj funksionimin efektiv të kontrolleve në mënyrë që procedimi i pagave ndaj lehonave dhe të tjerëve të verifikohen paraprakisht për të shmangur pagesat e parregullta.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
4.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja përmes menaxherit të financave duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet klasifikohen në kode ekonomike adekuate, në mënyrë që shpenzimet të prezantojnë gjendjen reale.	Edhe këtë vit kemi hasur në keqklasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të siguroj qasje në dokumente publike që kanë të bëjnë me shpenzimin e parasë publike duke qenë transparent, në mënyrë që të shmangen kostot nga shqiptimi i gjobave nga institucionet kompetente.	Nuk kemi hasur në ndonjë rast të tillë këtë vit.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të vendosë kontrolle efektive që parandalojnë tejkalimet e shpenzimeve të qirasë sipas rregullave të përcaktuara / të përditësuara nga Ministria. Po ashtu, shefat e MDK-ve duhet të kujdesen për një menaxhim më ekonomik të marrjes së banesave me qira.	Me hyrjen në fuqi të rregullores së re për kompensim të shpenzimeve për anëtarët në shërbimin e jashtëm është përmirësuar gjendja nga vitet paraprake dhe tejkalimet e identifikuar këtë vit ishin në vlera minimale.	I zbatuar
7.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja edhe më tej duhet të siguroj përmes shefave të MDK-ve që raportimi i shpenzimeve të bëhet në kohë të përcaktuar në mënyrë që MPJD të mund të bëjë regjistrimin e shpenzimeve në SIMFK në kohën e duhur dhe të siguroj se çdo raport kontrollohet dhe nënshkruhet nga shefat e misioneve.	Në këtë vit kemi identifikuar vetëm një rast nga mostrat e testuar, ka përmirësim në raport me vitet paraprake.	I zbatuar
8.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të shtoj nivelin e kontrollit mbi menaxhimin e shpenzimeve për të racionalizuar ato. Në rastet kur ka tejkalime të pa arsyetuara duhet të të ndërmerren veprime për kthimin e mjeteve në buxhetin e Ministrisë.	Nuk kemi identifikuar tejkalim të shpenzimeve të lejuara.	I zbatuar

9.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja edhe më tej duhet të siguroj përmes shefave të MDK-ve që mbajtja e evidencave të bëhet për secilin automjet zyrtar dhe përdorimi i tyre të jetë në përputhje me objektivat e MDK-së. Po ashtu, raportet mujore të dërgohen në divizionin përkatës sipas kërkesave të rregullores në fuqi.	Përsëri edhe këtë vit nuk janë bërë raportimet e rregullta në Divizionin e logjistikës.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të siguroj që komisionet e vlerësimit në bashkëpunim me menaxherin e prokurimit i respekton të gjitha procedurat dhe kriteret gjatë vlerësimit në mënyrë që OE fitues të jenë të përgjegjshëm.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
11.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministrja duhet të siguroj një kontroll efektiv të obligimeve që rrjedhin nga aktivitetet e Ministrisë në mënyrë që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor për të shmangur penalizimet për shkak vonesave.	Raste të njëjta kemi identifikuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
12.	Investimet kapitale	Ministrja përmes menaxheres së prokurimit duhet të siguroj që të gjitha kontratat të jenë pjesë e raportit vjetor duke bashkëpunuar edhe me KRPP për të parë mundësinë që kjo të bëhet përmes sistemit e-prokurimi. Po ashtu, duhet të siguroj një planifikim më të mirë të prokurimit bazuar në nevojat për të eliminuar prokurimet jashtë planit.	Kontratat e nënshkruara nga MDK-të në vitin 2023 përsëri nuk ishin përfshirë në raportin e kontratave vjetore publike.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Fjolla Bakalli Sadiku, Udhëheqëse e ekipit



Lumturije Sopi, Anëtare e ekipit



Sabile Muli, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
Nr. Orig. Orig. No.	10
Nr. Flet. Flet. No.	2306
Nr. Kopje No. Pages	01
Data Date	17.05.24
Prishtine / a	



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - Ministarstvo Inostranih Poslova i Diaspore -
 Ministry of Foreign Affairs and Diaspora

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, për vitin 2023;
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; me lejon t'ju sigurojë se në të gjitha kapacitetet e mia do të përkujdesem që rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit të adresohen;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Znj. Donika Gervalla Schwarz

Zv. Kryeministre / Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Data: 16 maj 2024, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.